

VENDIM
Nr. 617, datë 18.9.2019

**PËR PËRCAKTIMIN SI “ZONË TË LIRË”, TË NJË PJESE TË TERRITORIT
DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PORTO-ROMANO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 216, të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin si “Zonë të lirë” të një pjese të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në Porto-Romano.

2. Planvendosja e zonës së lirë dhe pikat e hyrjes e të daljes përcaktohen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ushtrimi i veprimtarisë në zonën e lirë do të autorizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas plotësimit nga aplikuesi të kushteve dhe të kriterëve të parashikuara në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë qëllim.

4. Të gjitha shpenzimet për rrethimin e zonës së lirë, plotësimin e kushteve të punës dhe për sistemet e monitorimit me videokamerat e ndriçimit, për ushtrimin e mbikëqyrjes nga autoritetet doganore, të përcaktuara në legjislacion, do të kryhen me shpenzimet e aplikuesit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

